

KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN



MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN



PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| HYRJE | 3 |
| KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN | 4 |
| VENDIM Nr. 690, datë 22.11.2017 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën” | 5 |
| URDHËR Nr. 231, datë 7.12.2017 “Për Përbërjen dhe Detyrat e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën” | 7 |
| KOORDINATORËT SHTETËRORË | 8 |
| URDHËR Nr. 45, datë 12.2.2019 “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Informimin e Diasporës” | 8 |
| URDHËR Nr. 43, datë 12.2.2019 “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Sigurimeve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vëndit” | 9 |
| URDHËR Nr. 44, datë 12.02.2019 “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare” | 10 |
| URDHËR Nr. 47, datë 18.2.2019 “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Programet/Donatorët të Cilët Ofrojnë Bursa Studimi për Jashtë Vëndit” | 11 |
| URDHËR Nr. 78, datë 17.4.2019 “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Marrëveshjet Shtetërore në Fushën e Njohjes së Lejeve të Drejtimit të Automjeteve për Shtetasit Shqiptarë Jashtë Vëndit” | 12 |
| URDHËR Nr. 92, datë 17. 05. 2019 “Për Ngritjen e Grupit të Punës dhe Caktimin e Personit Përgjegjës për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve që Vuajnë Heqjen e Lirisë Jashtë Vëndit, të Drejtave të Migrantëve Nëpërmjet Informimit mbi Mundësitë e Ndryshme për të Apeluar Ndaj Shkeljeve të të Drejtave të Tyre, në Strukturat e Vendeve Pritëse si dhe në ato Ndërkombëtare” | 13 |
| URDHËR Nr. 112, datë 30.8.2019 “Për Caktimin e Koordinatorit Shtetëror për Realizimin e Programit “JAM SHQIPTAR” të Gjuhës dhe Kulturës Shqipe | 15 |
| JETËSHKRIMET E KOORDINATORËVE SHTETËRORË | 18 |


Hyrje

Kontributi i Diasporës ndër vite është me rëndësi thelbësore për historinë e kombit shqiptar. Duke u bazuar në rëndësinë e angazhimit të Diasporës në zhvillimin ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit, politikëbërësit dhe institucionet shtetërore vijnë me zhvillimin dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse për marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Diasporën.

Komiteti Shtetëror për Diasporën, i miratuar me Vendimin nr. 690, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, është ndër strukturat kryesore përgjegjëse për zhvillimin e politikave për Diasporën. Misioni i Komitetit është përgatitja e linjave orientuese për politikën e reja në fushën e Diasporës, propozimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për përmirësimin e pozitës së shqiptarëve jashtë vendit si edhe nxitja e dialogut dhe koordinimit për zbatimin e Strategjisë. Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje disa anëtarë të kabinetit që drejojnë ministritë që lidhen me zhvillimin dhe fushat e mundshme të bashkëpunimit e kontributit të Diasporës.

Një rol kryesor në koordinimin e punës për zbatimin e politikave shtetërore për Diasporën shqiptare kanë edhe koordinatorët shtetërorë, të cilët janë përcaktuar me urdhër të Kryeministrit.

Materiali i paraqitur më poshtë është një përmbledhje e vendimeve të miratuara dhe strukturave përgjegjëse lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e politikave shtetërore për Diasporën.



KOMITETI SHTETËROR

KRYEMINISTRI

**SEKRETARIATI
TEKNIK**

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

**MINISTRIA PËR
EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME**

**MINISTRIA E
BRENDSHME**

**MINISTRIA E
FINANCEVE DHE
EKONOMISË**

**MINISTRIA E
DREJTËSISË**

**MINISTRIA E
ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**

**MINISTRIA E
KULTURËS**

**MINISTRI PËR
EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME**

**MINISTRI I BRENDSEM
PUNËT E JASHTME**

**MINISTRI I FINANCEVE
DHE EKONOMISË**

**MINISTRI I
DREJTËSISË**

**MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË**

**MINISTRI I
KULTURËS**

**MINISTRI I MJEDISIT
DHE TURIZMIT**

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

**GUVERNATORI I BANKËS
SË SHQIPËRISË**

**KRYETARI I AKADEMISË
SË SHKENCAVE**

DREJTORI I INSTAT

KOORDINATORI SHTETËROR PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

KOORDINATORI SHTETËROR PËR INFORMIMIN E DIASPORËS

KOORDINATORI SHTETËROR PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E NJOHJES SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

KOORDINATORI SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË AKTIVITETEVE PËR DIASPORËN SHQIPTARE

KOORDINATORI SHTETËROR PËR PROGRAMET/DONATORËT TË CILËT OFROJNË BURSA STUDIMI PËR JASHTË VENDIT

KOORDINATORI SHTETËROR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT "JAM SHQIPTAR" TË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE

PERSONI PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE QË VUAJNË HEQJEN E LIRISË JASHTË VENDIT, TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NËPËRMJET INFORMIMIT MBI MUNDËSITË E NDRYSHME PËR TË APELUAR NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË TYRE, NË STRUKTURAT E VENDEVE PRITËSE SI DHE NË ATO NËRËKOMBËTARE

KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN


V E N D I M
Nr. 690, datë 22. 11. 2017

PËR **KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHTETËROR** **PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, këtu e në vijim Komiteti, si organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës.
2. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij këta anëtarë:
 - a) Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - b) Ministrin e Brendshëm;
 - c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
 - d) Ministrin e Drejtësisë;
 - e) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - f) Ministrin e Kulturës;
 - g) Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit;
 - h) Ministrin e Shtetit për Diasporën;
 - i) Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë;
 - j) Kryetarin e Akademisë së Shkencave;
 - k) Drejtorinë e INSTAT-it.
3. Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:
 - a) përgatitjen e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në fushën e diasporës;
 - b) propozimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për çështje që lidhen me përmirësimin e pozitës së anëtarëve të diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku jetojnë;
 - c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit në fushën e zhvillimit të komuniteteve të diasporës;
 - d) koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
 - e) mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën.
4. Komiteti mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sa herë është e nevojshme, me kërkesë të Kryeministrit.

- 
5. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të grupeve parlamentare, të organeve të qeverisjes qendrore e vendore apo të institucioneve të tjera, pjesëmarrja e të cilëve çmohet e vlefshme për përmbushjen e misionit.
 6. Veprimtaria e Komitetit mbështetet nga sekretariati teknik. Përbërja dhe detyrat e sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.
 7. Urdhri nr.115, datë 11.5.2006, i Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërministror të Migracionit”, shfuqizohet.
 8. Ngarkohen anëtarët e Komitetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

URDHËR


Nr. 231, datë 7.12.2017

PËR PËRBËRJEN DHE DETYRAT E SEKRETARIATIT TEKNIK TË KOMITETIT SHETETËROR PËR DIASPORËN

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 6 të vendimit nr. 690, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën”,

URDHËROJ:

1. Sekretariati Teknik i Komitetit Shtetëror për Diasporën të kryesohet nga përfaqësuesi i ministrit të Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të ketë anëtarë, përfaqësues nga:
 - Ministri i Shtetit për Diasporën;
 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Ministria e Brendshme;
 - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
 - Ministria e Drejtësisë;
 - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - Ministria e Kulturës;
2. Detyrat kryesore të Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën janë, si më poshtë vijon:
 - Të përgatitë takimet e Komitetit;
 - Të raportojë periodikisht pranë Komitetit për realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme të tij;
 - Të bashkërendojë punën ndërmjet institucioneve të përfshira për zbatimin dhe monitorimin e detyrave të lëna nga Komiteti;
 - Të mbajë procesverbalet dhe të hartojë vendimet e marra nga Komiteti;
 - Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga kryetari i Komitetit.
3. Sekretariati teknik të mbledhet rregullisht, me njoftimin e kryetarit.
4. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij urdhri, që brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të tij, t’i dërgojnë ministrit të Shtetit për Diasporën emrat e përfaqësuesve të tyre në sekretariat.

- 
5. Ngarkohen anëtarët e Sekretariatit Teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën për ndjekjen e zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

KOORDINATORËT SHTETËRORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KRYEMINISTRI

U R D H Ë R
Nr. 45, datë 12.2.2019

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR INFORMIMIN E DIASPORËS

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e drejtorit të Programimit dhe Zhvillimit, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), z. Fatjon Hallkaj, koordinator shtetëror për informimin e diasporës shqiptare.
2. Koordinatori shtetëror vepron në zbatim të masës 51, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendim nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave. Ai vlerëson dhe koordinon punën për informacionin që publikohet nga institucionet e administratës shtetërore për interesat e komunitetit shqiptar jashtë vendit.
3. Për këtë proces, koordinatori shtetëror të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R
Nr. 43, datë 12.2.2019

PËR
CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR
PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE
PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Etjen Xhafaj, si koordinator shtetëror për ndjekjen e procesit të inicimit, negocimit dhe finalizimit të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, në zbatim të masës 23, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme autorizohet të zhvillojë bisedimet për inicimin dhe negocimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.
3. Për këtë proces koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R
Nr. 44, datë 12.02.2019

PËR
CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN
E PROGRAMIT VJETOR TË AKTIVITETEVE PËR DIASPORËN
SHQIPTARE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit të Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Çuçi, si koordinator shtetëror për ndjekjen dhe organizimin e programit vjetor të aktiviteteve shtetërore në interes të diasporës shqiptare dhe “Ditët e Shqipërisë”, për zbatimin e masës 45, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit është përgjegjës dhe autorizohet të koordinojë e organizojë aktivitete në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar.
3. Për këtë proces koordinatori shtetëror të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjet e Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R
Nr. 47, datë 18.2.2019

PËR
CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR
PËR PROGRAMET/DONATORËT TË CILËT OFROJNË BURSA
STUDIMI PËR JASHTË VENDIT

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino, si koordinator shtetëror për ndjekjen e programeve dhe donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit, në zbatim të masës 64, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë është përgjegjës dhe autorizohet të koordinojë punën ndërinstitucionale për ndjekjen dhe realizimin e masës 64, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
3. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

**U R D H Ë R
Nr. 78, datë 17.4.2019**

**PËR
CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR
PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E NJOHJES
SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE PËR SHTETASIT
SHQIPTARË JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 28, të Ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit nr. 510, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë të Shtetit për Diasporën” dhe të vendimit nr. 504, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin e zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli si koordinator shtetëror për ndjekjen e procesit të negocimit të marrëveshjeve dypalëshe shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit.
2. Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjës për koordinimin ndër-institucional për negocimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.
3. Për këtë proces raportohet me shkrim çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI


U R D H Ë R
Nr. 92, datë 17. 05. 2019

PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS DHE CAKTIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN
E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE QË VUAJNË HEQJEN E LIRISË JASHTË VENDIT,
TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NËPËRMJET INFORMIMIT MBI MUNDËSITË E NDRYSHME
PËR TË APELUAR NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË TYRE, NË STRUKTURAT
E VENDEVE PRITËSE SI DHE NË ATO NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

U R D H Ë R O J:

1. Ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për zbatimin e masës 24, dhe 44 të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi i punës do të kryesohet nga zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka si person përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve, nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare dhe në përbërje të ketë:
 - a) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë; b) një përfaqësues të caktuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; c) një përfaqësues të caktuar nga ministri i Shtetit për Diasporën.
3. Grupi i punës është përgjegjës në koordinimin e punëve ndërinstitucionale për mbledhjen e informacionit të plotë, për ndjekjen dhe trajtimin sipas legjislacionit në vendet pritëse, të shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit.
4. Zëvendësministri i Drejtësisë, me qëllim përmbushjen e kësaj detyre bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për politikën e jashtme, Avokatin e Popullit apo organizma të shoqërisë civile, me qëllim informimin mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.

- 
5. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, grupi i punës raporton, me shkrim çdo 3 muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
 6. Institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij urdhri caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin e punës brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
 7. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

**U R D H Ë R
Nr. 112, datë 30.8.2019**

**PËR
CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR PËR REALIZIMIN
E PROGRAMIT “JAM SHQIPTAR” TË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të vendimit nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”,

U R D H Ë R O J:

1. Caktimin zëvendësministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lorena Haxhiu, si Koordinator Shtetëror për ndjekjen, organizimin dhe raportimin e punës për realizimin e Programit “Jam Shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe në bazë të memorandumit të nënshkruar për këtë qëllim ndërmjet institucioneve përgjegjëse në zbatimin e masës 28, të planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin Nr. 259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë autorizohet të koordinojë punën ndërinstytucionale për ndjekjen dhe realizimin e Programit “Jam Shqiptar” të gjuhës dhe kulturës shqipe. Për realizimin dhe ecurinë e procesit, koordinatori të raportojë, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e radhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

KOORDINATORËT SHETËTORË



KOORDINATORI SHETËTOR PËR MARRËVESHJET
SHETËTORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE PËR
SHETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Etjen Xhafaj (Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme)
Etjen.Xhafaj@mfa.gov.al



KOORDINATORI SHETËTOR PËR ORGANIZIMIN E
PROGRAMIT VJETOR TË AKTIVITETEVE PËR DIASPORËN
SHQIPTARE

Ornela Çuçi (Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit)
Ornela.cuci@turizmi.gov.al



KOORDINATORI SHETËTOR PËR INFORMIMIN E
DIASPORËS

Fatjon Hallkaj (Drejtor, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit)
fatjon.hallkaj@akshi.gov.al



KOORDINATORI SHETËTOR PËR PROGRAMET/
DONATORËT TË CILËT OFROJNË BURSA STUDIMI
PËR JASHTË VENDIT

Redi Shtino (Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë)
redi.shtino@arsimi.gov.al



KOORDINATORI SHTETËROR PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE
NË FUSHËN E NJOHJES SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE PËR
SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Artan Shkreli (Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë)
artan.shkreli@infrastruktura.gov.al



PERSONI PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE QË
VUAJNË HEQJEN E LIRISË JASHTË VENDIT, TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE
NËPËRMJET INFORMIMIT MBI MUNDËSITË E NDRYSHME PËR TË APELUAR
NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË TYRE, NË STRUKTURAT E VENDEVE
PRITËSE SI DHE NË ATO NDËRKOMBËTARE

Fjoralba Caka (Zëvendësministre e Drejtësisë)
fjoralba.caka@drejtesia.gov.al



KOORDINATORI SHTETËROR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT
“JAM SHQIPTAR” TË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE

Lorena Haxhiu (Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë)
lorena.haxhiu@arsimi.gov.al

JETËSHKRIMET E KOORDINATORËVE SHTETËRORE



KOORDINATORI SHTETËROR PËR MARRËVESHJET
SHTETËRORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE PËR
SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Etjen Xhafaj (Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme)

Etjen Xhafaj ka lindur në Vlorë, më 6 Prill, 1982, ku edhe kreu studimet e ciklit të ulët. Shkollën e mesme e ndoqi në Tiranë (“Ismail Qemali”) dhe në Los-Anxheles, CA, pranë “Southwestern Academy”. Studimet e larta i nisi pranë “Community College of Philadelphia”, PA dhe i përfundoi në vitin 2004 pranë “Schiller International University”, Paris, Francë, për “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”, niveli Bachelor. Në vitin 2016 Etjen Xhafaj ka përfunduar studimet në nivelin Master Shkencor për “Administrim Publik,” pranë “Kennedy School of Government” të Universitetit të Harvardit, në Kembrixh, MA, SHBA, ku gjithashtu është angazhuar si hulumtues (research fellow), pranë Qendrës për Zhvillim Ndërkombëtar.

Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 2005, duke punuar pranë “Financial Services Volunteer Corps”, një organizatë e USAID-it, në fushën e asistencës teknike për sektorin financiar, si Oficer Programi, deri në vitin 2008. Gjatë kësaj periudhe e deri në vitin 2013, ai ka qenë gjithashtu një opinionist pranë “Albanian Daily News”, dhe pas shtatorit të vitit 2013 ka shërbyer si Këshilltar i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes e më pas (dhjetor 2013- qershor 2015), si Drejtor Kabineti i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Gjatë periudhës, qershor 2016 – qershor 2017 Xhafaj ka punuar si Drejtor Kabineti i Ministrit të Financave,

Ndër vite, Xhafaj është përfshirë në studime të ndryshme mbi zhvillimet politike e ekonomike, duke bashkëpunuar me shoqata e institute të ndryshme (“NDI”, “Friedrich Ebert Stiftung”, “Olof Palme Foundation”, Instituti për Kërkimin mbi Median etj.), si: “Analiza SWOT për zhvillimin e qëndrueshëm të Vlorës” publikuar nga “Agenda Institute”, studimi i NDI-së mbi periudhën e tranzicionit në Evropën Perëndimore, në bashkëpunim me kolegë nga parti të majta të Evropës Lindore. Xhafaj ka përkthyer një sërë tekstesh, studimesh e dokumentesh zyrtare, ndër të cilat vlen të përmenden korrespondencat zyrtare të Ministrisë së Jashtme Britanike 1912-1914, publikuar nga Prof. Valentina Duka me titullin “Shqipëria dhe shqiptarët në dokumentet zyrtare Britanike” botuar nga TOENA.



**KOORDINATORI SHTETËROR PËR ORGANIZIMIN
E PROGRAMIT VJETOR TË AKTIVITETEVE
PËR DIASPORËN SHQIPTARE**

Ornela Çuçi (Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit)

Znj. Ornela Çuçi ka lindur në Gjirokastrë në vitin 1982 dhe është nënë e dy djemve.

Në vitin 2004 kreu studimet pranë universitetit “Eqerem Çabej” në Gjirokastrë, për Biologji dhe Kimi. Më pas në vitin 2009 përfundoi studimet master pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, për Shkencë dhe Teknologji Mjedisore. Pranë këtij universiteti që nga viti 2017 mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, bazuar në kërkimin shkencor mbi impaktin e menaxhimit të mbetjeve urbane dhe ndotjen e tokave në jug të Shqipërisë (rast studimor, qarku i Gjirokastrës).

Fillimisht u angazhua si asistente për shoqatën “Local Infrastructure Development Agency” (2003-2005) e më pas si specialiste e shërbimeve në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, sektori i Kompetencave Vendore (2005-2013). Në vijim u emërua Drejtore e Projekteve në “Albanian University” për periudhën kohore 2013-2017 e mandej në Universitetin Evropian të Tiranës si Drejtore e Qendrës së Kërkimit Shkencor në Universitetin “Marin Barleti”. Në të njëjtën kohë, u angazhua me kohë të pjesshme si koordinatore, shkruese e zbatuese e shumë projekteve pranë Institucionit të Prefektit të Gjirokastrës, Këshillit të Qarkut të Gjirokastrës, Universitetit Evropian të Tiranës, Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe një sërë OJF-ve brenda dhe jashtë vendit. Në vitet 2009-2014 ka qenë eksperte e lirë për Ministrinë e Mjedisit për ekspertizën dhe auditimin mjedisor.

Prej vitit 2011 e deri më sot znj. Çuçi shërben si lektore e ftuar në Universitetin e Gjirokastrës, Universitetin Evropian të Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës dhe është autore e shumë shkrimeve dhe studimeve të publikuara në revista shkencore vendase dhe të huaja për fushën e mjedisit.

Nga viti 2014 e në vazhdim ekspertiza e saj në fushën e projekteve kaloi në nivel “Vlerësues i projekteve të Bashkimit Evropian” për projektet e zbatuara “IPA Adrion” dhe më tej për projektet “Horizon 2020”, “Marie Skłodowska-Curie Actions”. Që prej vitit 2016, është Këshilltare e Kryeministrit mbi çështjet mjedisore dhe Koordinatore Kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane. Ajo zotëron shumë mirë gjuhën angleze, greke, frënge dhe italiane.



KOORDINATORI SHTETËROR
PËR INFORMIMIN E DIASPORËS

Fatjon Hallkaj (Drejtor, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit)

Z. Fatjon Hallkaj ka përfunduar studimet në ciklin Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në Universitetin e Tiranës (për periudhën kohore 2012-2015). Më 2018 kreu Masterin Shkencor në Informatikë në Universitetin e Tiranës.

Gjatë periudhës shtator 2017- korrik 2018 ai ka drejtuar sektorin e Programimit dhe Zhvillimit në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.



KOORDINATORI SHTETËROR PËR PROGRAMET/
DONATORËT TË CILËT OFROJNË BURSA STUDIMI
PËR JASHTË VENDIT

Redi Shtino (Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë)

Z. Redi Shtino, ka lindur në Tiranë në vitin 1974. Ai mban titullin Doktor i Shkencave në fushën e të Drejtës Parlamentare (Fakulteti Juridik-Universiteti i Tiranës) dhe është gjithashtu kandidat për titullin doktor në të Drejtën Penale të Krahësuar (Fakulteti Juridik i Universitetit të Bolonjës) dhe në të Drejtën Kushtetuese (“Alta Scuola Europea Alberigo”, Bolonjë). Ai ka një karrierë të gjatë në fushën e Drejtësisë në vend dhe në shtetin fqinj Itali. Përpos këtyre, z. Shtino ka qenë i angazhuar në fushën akademike në mësimdhënie në disa universitete të vendit dhe në Universitetin e Bolonjës në Itali, ku kontribuon si profesor i jashtëm, në lëndët e profilit të tij. Ka punuar si këshilltar juridik brenda dhe jashtë vendit. Gjatë viteve 2013-2016, z. Shtino ka qenë koordinator në bashkëpunim i programit të doktoraturës PhD pranë universitetit “LUM, Jean Monnet” në Itali. Nga viti 2016 e në vazhdim është anëtar i “Horizon 2020 Strategic Configuration Programme Committee”. Ai e ka mbajtur edhe më parë postin e Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit në vitet 2016-2017, duke vijuar më 2018-2019 në pozicionin e këshilltarit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë. Z. Shtino është autor i një sërë punimesh shkencore dhe tekstesh universitare në fushën e Drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit.



COORDINATORI SHTETËROR PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE
NË FUSHËN E NJOHJES SË LEJEVE TË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE
PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT

Artan Shkreli (Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë)

Z. Artan Shkreli ka lindur më 8 mars të vitit 1964 në Tiranë. Është i martuar dhe ka tre fëmijë. Ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Arkitekturë.

Në vitin 1991 u specializua në Itali si “Progettista assistito da CAD” dhe u punësua si arkitekt në Bolonjë, Itali. Në vitet 1995-1996 kreu specializimin pranë “Cuppini e Associati” në sektorin e restaurimit arkitekturor. Ka kryer kursin pasuniversitar për “Energy Efficiency” në banesa, organizuar në Ohër të Maqedonisë nga “Eko Zentrum”. Ka punuar si përgjegjës për programet ndërkombëtare pranë “Ricerca & Progetto” në Bolonjë, orientuar në problematikat e bioarkitekturës.

Z. Shkreli ka krijuar OJF-në “Fondi Shqiptar për Monumentet” (Albanian Fund for Monuments) me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të vendit. Nga viti 1998 deri në vitin 2002 ka qenë drejtor i përgjithshëm i Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Z. Shkreli ka qenë anëtar i kryesisë së seksionit shqiptar të ICOMOS-it (International Council on Monuments and Sites). Në periudhën kohore 2003-2005 ka qenë këshilltar i kryeministrit në fushën e Planifikimit Urban dhe Infrastrukturor. Në vitin 2008-2012 z. Shkreli ka mbajtur postin e kryetarit të Shoqatës së Arkitektëve të Shqipërisë (SHASH), për të vijuar më pas në vitet 2013-2017 në pozicionin e Këshilltarit për Territorin pranë kryeministrit Edi Rama.

Z. Shkreli është autor i mbi 200 projekteve arkitekturore, restauruese, dizajni, mjedisore e urbanistike në Shqipëri e Itali. Që nga shtatori i vitit 2017 është zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.



PERSONI PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE QË VUAJNË HEQJEN E LIRISË JASHTË VENDIT, TË DREJTAVE TË MIGRANTËVE NËPËRMJET INFORMIMIT MBI MUNDËSITË E NDRYSHME PËR TË APELUAR NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË TYRE, NË STRUKTURAT E VENDEVE PRITËSE SI DHE NË ATO NDËRKOMBËTARE

Fjoralba Caka (Zëvendësministre e Drejtësisë)

Znj. Fjoralba Caka është diplomuar si studente e shkëlqyer në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës dhe zotëron diplomë Master në të Drejtën e Biznesit në Bashkimin Evropian nga i njëjti fakultet. Ka qenë pjesë e programit “Fulbright” dhe ka përfunduar studimet Master (LLM) për Biznes Ndërkombëtar dhe të Drejtën e Korporatave në Universitetin e San Diegos (SHBA). Ajo ka qenë studiuese vizitore në Institutin “Max Planck” për të Drejtë Ndërkombëtare Krahasuese dhe Private (Gjermani), në “Washington & Lee University” (SHBA) dhe në “Europa-Institut” (Gjermani). Mban titullin “Doktor” nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

Që nga viti 2008, znj. Caka ka punuar si lektore me kohë të plotë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës. Ajo është përqendruar kryesisht në fusha kërkimore, si: E Drejta e Bashkimit Evropian, e Drejta e Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës në BE, OBT dhe marrëveshjet ndërkombëtare të tregtisë. Fjoralba është gjithashtu trajnere për gjyqtarët në Shkollën e Magjistraturës në lëndën e së Drejtës së Bashkimit Evropian.

Znj. Caka ka qenë avokate për çështje që lidhen me të drejtën private dhe eksperte në një numër projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare. Ajo ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile në rastet e litigimit strategjik, ka udhëhequr fushata antikorrupsion dhe ka qenë anëtare e bordit në OJF të ndryshme.

Prej Marsit 2019, Fjoralba Caka shërben si Zëvendësministre e Drejtësisë, ku mbulon kryesisht çështje të integritimit evropian, anti-korrupsionit dhe reformës në drejtësi.



KOORDINATORI SHTETËROR PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT
“JAM SHQIPTAR” TË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE

Lorena Haxhiu (Zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë)

Znj. Lorena Haxhiu lindi në qytetin e Tiranës, më 8 maj të vitit 1991.

Znj. Haxhiu mban titullin Master i Shkencave në Marketing, nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, me vlerësim maksimal (mesatare 10). Ka përfunduar studimet Bachelor, në degën Financë, në po të njëjtin institucion publik të arsimit të lartë. Arsimin e mesëm e kreu në Shkollën e Mesme Teknike-Ekonomike, në profilin Bankë, me rezultate të shkëlqyera. Prej nëntorit të vitit 2017, znj. Haxhiu ka mbajtur detyrën e Drejtores së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar për Rininë, institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përgjegjëse për implementimin e politikave rinore në Shqipëri.

Pas përfundimit të studimeve master është angazhuar si pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në fushën e marketingut.

Znj. Haxhiu numëron rreth 10 vite përvojë pune në media. Ajo është angazhuar me kohë të plotë si moderatore televizive, në programe të përditshme me profil social, ekonomik, kulturor dhe sportiv. Gjithashtu ka punuar në pozicione drejtuese në disa prej mediave të shkruara dhe elektronike në vend.

Znj. Haxhiu zotëron gjuhën angleze, italiane dhe gjermane.